

LIGJ
Nr.10 108, datë 2.4.2009

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE E NDRYSHIMEVE NË “MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS, DURRËS”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.9298, DATË 28.10.2004, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohen disa shtesa e ndryshime në “Marrëveshjen e koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, ratifikuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6137, datë 17.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

SHITESË

NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM, TRANSFERIM), PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PONTILIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NË ZONËN BREGDETARE TË PORTO-ROMANOS, DURRËS

Sot më datë _____ 2009, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e përfaqësuar nga “Organi Shtetëror i Autorizuar” OSHA, i përbërë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

dhe

shoqërisë Koncesionare “Romano Port”, me seli në Durrës, e regjistruar si person juridik me vendimin nr.30465, datë 28.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, i përfaqësuar nga aksionari i shoqërisë _____ me vendimin të asamblesë së aksionarëve, e cila sipas rastit është dakord me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe është dakord me këtë përmbajtje të kësaj marrëveshjeje.

Duke pasur parasysh që në marrëveshjen e koncesionit të nënshkruar më datë 8.9.2004, të miratuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit të formës “Bot” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos”, Durrës, të ndryshuar me ligjin nr.9578, datë 11.7.2006 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Marrëveshjen e koncesionit të formës “Bot” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”, palët konstatojnë në interes të përbashkët për të finalizuar ndërtimin e pontilit në Porto-Romano, Durrës, të bëjnë ndryshimet e mëposhtme në këtë Marrëveshje:

Neni 1

Termi “Marrëveshje e ndryshuar”, i referohet marrëveshjes së koncesionit të nënshkruar më datë 8.9.2004, miratuar me ligjin nr.9298, datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së koncesionit të

formës “Bot” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës””, të ndryshuar me ligjin nr.9578, datë 11.7.2006 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit të formës “Bot” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës””.

Neni 2

Në nenin 2 të marrëveshjes së ndryshuar “Objekti i koncesionit”, pas fjalëve “...për ndërtimin e pontilit” shtohet fjala “...dhe dallgëthyesit”, dhe në fund të nenit 2, pas fjalëve “...sipas projektit të miratuar” shtohet grup togfjalësh “...në KRRTRSH”.

Neni 3

Në nenin 3 të marrëveshjes së ndryshuar “Transferimi në shtet”, në paragrafin e parë, para “...fjalëve ...instalimet bregdetare” shtohen fjalët “...dhe dallgëthyesit”.

Neni 4

Në aneksin 5 të marrëveshjes së ndryshuar, në pikën 1.7, pas fjalës “Pontilin” shtohen fjalët “...dhe dallgëthyesin”.

Neni 5

Në nenin 13 të marrëveshjes së ndryshuar, përmbajtje e dispozitës “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” ndryshohet si më poshtë:

“...Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve nuk do të ndërpresë ekzekutimin e detyrimeve dhe në qoftë se nuk zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhet me ndihmën e një arbitri pajtimi, të emëruar me vullnet të të dy palëve dhe të një eksperti të emëruar nga OSHA-ja dhe një të emëruar nga Koncesionari.

Në rast mospajtimi të mëtejshëm, marrëveshja do të zgjidhet duke iu drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ligji i zbatueshëm është legjislacioni shqiptar në fuqi.”.

Neni 6

Forma e veçantë e mbështetjes nga qeveria dhe garantimi i investimeve të parashikuara në nenin 8 të marrëveshjes së ndryshuar, me përmbajtje, si vijon: “...Të përjashtojë koncesionarin nga të gjitha tatimet, taksat dhe detyrimet doganore vetëm për materialet, pajisjet, instrumente teknike që importohen me qëllim ndërtimin e pontilit dhe infrastrukturës përkatëse sipas projektit të miratuar. Ky përjashtim mbaron me përfundimin e ndërtimit të objektit...”, do të vijojë të përfitohet nga koncesionari për periudhën nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje pas ratifikimit në Kuvend dhe deri në datën 31.5.2009, dhe për objektin e dallgëthyesit, sipas projektit të miratuar në vendimin e KRRTRSH-së të vitit 2009, në sasinë e caktuar në preventivin bashkëlidhur, pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Përfundimi i dallgëthyesit të realizohet në dy faza:

Faza e parë. Deri më datë 31.5.2009 koncesionari të bëjë efektiv dallgëthyesin për të gjithë gjatësinë e tij, për të garantuar funksionimin normal të portit të shkarkimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos.

Faza e dytë. Deri më datë 31.5.2010 koncesionari, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e disiplinimit të ndërtimit, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të ketë përfunduar kolaudimin tekniko-ekonomik të objektit dallgëthyes, të miratuar me lejen e ndërtimit të KRRTRSH-së dhe marrjen e lejes së shfrytëzimit pranë zyrës së urbanistikës së njësisë vendore Katund i Ri për këtë objekt.

Neni 8

Hyrja në fuqi e marrëveshjes

Marrëveshja u përpilua në gjuhën shqipe. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë.

PËR OSHA-NË
 MINISTRI I EKONOMISË TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli
 MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE
 TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi
 MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
 UJËRAVE
Lufter Xhuveli

Për Koncesionarin
 I autorizuari, në vëmendje Asamblesë së
 Aksionerëve të shoqërisë "Romano-Port sh.a,
 datë 10.2.2009

Piro Bare

PREVENTIVI PËR PUNIME NDËRTIMORE PËR DALLGËTHYESIN E PORTIT NË PORTO-
 ROMANO, DURRËS

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi per njesi (pa TVSH)	Vlera ne 000/ leke
1.	FV Gure	m3	800.000	1.500	1,200,000
2.	FV Zhavor	m3	40.000	833.3	33,332
3.	FV Material mbushes	m3	398.000	333.3	132,653.4
4.	FV Gjeotekstil	m2	40.000	800	32,000
5.	FV Kubik beoni 2.5	cope	10.000	20,333.3	203,333
6.	FV Kubik betoni 12.5	cope	2.000	101,666.7	203,333.4
Gjithsej:					1,804,651.8
TVSH 20%					360,930.4
TOTALI					2,165,582.2

Preventivuesi
Dhimiter MILAJA
 INZHINIERI
 PROJEKTIM-KONSTRUKCIM
 LIC: 038513

Drejtori ekzekutiv

Vet. **ROMANO**
 ROMANO
 PORT
 SH.A.
 Durrës - ALBANIA

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT "SHOQËRI ANONIME SH.A."**

GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NIPT)	K516255010
2. Data e Regjistrimit	19/04/2005
3. Emri i Subjektit	ROMANO PORT
4. Forma ligjore	Shoqëri Anonime
5. Data e themelimit	27/10/2003
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/10/2003 Deri:
7. Selia	Durres Durres DURRES Lagja 15, Porto Romano
8. Kapitali	307.220.000,00
9. Numri i Kontributeve vlera nominale	307.220,00 1.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Punimet e ndertimit, tregtim te materjaleve te ndertimit, etj
12. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Veli Hoxha Nga: 27/10/2003 Deri:
13. Kufizime të kompetencave	
14. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Afati i emërimit	Llazar Shandro Nga: 01/03/2006 Deri:

15. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Afati i emërimit	Hysni Troplini Nga: 01/03/2006 Deri:
16. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës Afati i emërimit	Artan Dulaku Nga: 01/03/2006 Deri:
17. Eksperti Kontabël i Autorizuar Afati i emërimit	Teit Gjini Nga: 01/03/2006 Deri:
18. Aksioner Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Pirro Bare 306.329,06 99,71
19. Aksioner Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Florenc Gjikutria 399,38 ,13
20. Aksioner Kontributet e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Xhevat Rira 491,55 ,16
21. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
22. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregëtar: ROMANO PORT
23. Statusi	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
1. 28/10/2002	Numri i Vendimit:30465, Gjykata:Tirane Data e regjistrimit:28.10.2003 Emri i subjektit:ROMANO PORT Forma ligjore:SHA Data e themelimit:27.10.2003 Selia:Durres,Porto Romano Kohëzgjatja:Mbi 20 vjet Kapitali:2.000.000 leke Objekti:Prodhim,eksport-import,tregetim te materialeve te ndertimit,si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes ,gazit,ujit dhe minierave.Studim projektim,ndertim te pontileve detare ne fushat hidro-termo zhurme izolimeve,Kualifikim,trajnim te specialisteve projektues dhe zbatues te projekteve ne fushat e prodhimit te lendeve dhe materialeve te ndertimit,si dhe per realizimin e punimeve dhe ndertimeve ne sektoret e naftes,gazit etj.Veprimtari sipermarje industriale,transport te

	mallrave dhe udhetareve. Krijimi i agjensive te Transportit rrugor, te mallrave dhe udhetareve, agjensive te punesimit dhe komisioneve te ndermjetesimit. Import eksport, transzitim, ndermjetesim, furnizim me energji elektrike, importim eksportim dhe tregetim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhim dhe shfrytezim te burimeve energjitike. Shtypshkrime tipografike, postera, flete palosje, shtepi botuese dhe tregetim i tyre me shumice e pakice. Organizim seminaresh e konferencash. Drejtor i Pergjithshem: Veli Hoxha Keshilli Mbikqyres: Piro Bare kryetar, Xhevat Rira zv kryetar, Dilaver Rexhepaj anetar. Aksionere: Artan Dulaku 33.3%; Piro Bare 33.3%, Xhevat Rira 33.3% Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
2. 28/01/2004	Numri i Vendimit: 30465/1, Gjykata: Tirane U vendos depozitimi i vendimit te mbledhjes se jashtezakonshme te shoqerise dtae 20.01.2004 ku eshte miratuar shitja nga ana e ortakeve te nje pjese te asioneve ne favor te Florenc Gjukuria. Ne baze te kontrates se shitjes Nr.256/43 dt.27.01.2004 rezulton se 400 aksione qe perfaqesojne 20% te kapitalit themeltar jane transferuar. Pas kesaj shitje kuotat e aksioneve qe zoterohen jane: Artan Dulaku zoterues i 540 aksioneve qe perfaqesojne 27% te kapitalit themeektar, Piro Bare zoterues i 560 aksione qe perfaqesojne 28% te kapitalit themeltar, Xhevat Rira zoterues i 500 aksioneve qe perfaqesojne 25% te kapitalit te shoqerise. Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
3. 25/05/2004	Numri i Vendimit: 30465/2, Gjykata: Tirane Me vendimin nr.2 te asamblese se aksionereve eshte miratuar shitja nga ana e aksionerit Artan Dulaku te aksioneve qe ai zoteron ne shoqeri nepermjet kontrates se shitjes te aksionereve ne favor te aksionerit Piro Bare, dhe largimin e aksionerit Artan Dulaku. Pas ketij veprimi shoqeria zoterohet nga aksioneret e meposhtem: Piro Bare 55% te aksioneve te kapitalit te shoqerise qe i takon 1100 aksioneve me vlere 1000 leke te nje aksioni. Xhevat Rira 25% te aksioneve te kapitalit te shoqerise qe i takon 500 aksioneve me vlere 1000 leke te nje aksioni. Florenc Gjukuria zoterues i 20% te aksioneve te kapitalit te shoqerise qe i takon 400 aksioneve me vlere 1000 leke te nje aksioni. Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
4. 19/12/2005	Numri i Vendimit: 30465/3, Gjykata: Tirane Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve te shoqerise me vendimin nr.7 date 05.12.2005 ka vendosur: Zmadhimi i kapitalit te shoqerise "ROMANO PORT" SHA. Kapitali i shoqerise do te zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja nga ana e shoqerise. Zmadhimi, emetimi i aksioneve te reja do te behet nepermjet kontributit ne para dhe kredive qe aksioneret i kane dhene shoqerise. Afati per shlyerjen dhe nenshkrimin me para ne dore te aksioneve te reja qe do te emetohen eshte 20 dite duke filluar nga data e celjes se nenshkrimeve. Data e celjes se nenshkrimeve eshte data e depozitimit te vendimit te Asmblese se Aksionereve ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates

	se Rrethit Gjyqesor Tirane. Caktimi i ekspertit Teit Gjini si ekspert kontabel per te bere vleresimin e kontributeve per zmadhimin e kapitalit. Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
5. 21/03/2006	Numri i Vendimit: 30465/4, Gjykata: Tirane U vendos depozitimi ne regjistrin tregtar i mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise ROMANO PORT" sha dhe te raportit te ekspertit kontabel te autorizuar per vleresimin e kontributeve per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ne shumen 307,220,000 leke i ndare ne 307,220 aksione me vlere nominale te nje aksioni 1000 leke. Raporti i zoterimit te aksioneve te kapitalit themeltar eshte si me poshte: 1. Piro Bare zoterues i 306,320 aksioneve me vlere 306,320,000 leke e barabarte me 99.71% te kapitalit themeltar te shoqerise. 2. Xhevat Rira zoterues i 500 aksioneve me vlere 500,000 leke e barabarte me 0.16% te kapitalit themeltar te shoqerise. 3. Florenc Gjukuria zoterues i 400 aksioneve me vlere 400,000 leke e barabarte me 0.13% te kapitalit themeltar te shoqerise. Ndryshimi i Keshillit Mbikqyres ndryshon dhe behet si me poshte : Artan Dulaku, Hysni Troplini, Llazar Shandro. Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
6. 14/02/2007	Numri i Vendimit: 30465/5, Gjykata: Tirane U vendos depozitimi i vendimit date 19.08.2006 ku eshte vendosur: Zmadhimi i kapitalit te shoqerise deri ne vleren prej 5,000,000 USD. Kapitali do te zmadhohet me emetim te aksioneve te reja nga ana e shoqerise. Caktimi i Teit Gjini si ekspert kontabel per te bere vleresimin e kontributeve per zmadhimin e kapitalit. Lista e Dokumenteve: EL.21.01.08.PJ (2).pdf
7. 27/12/2007	Numri i ceshtjes: CN-110115-12-07. Objekti ishte ("Punimet e ndertimit, tregtim te materjaleve te ndertimit, etj") u be ("Punimet e ndert, treg. mater. ndertimit, import perdorim pajisje detare, analiza lende djegese") Lista e Dokumenteve: Dokumenti origjinal i autorizimit nese aplikimi paraqitet nga perfaqesuesi i autorizuar ose fotokopje e noterizuar Aplikim per ndryshime ne te dhenat e regjistrimit
8. 12/05/2008	Numri i ceshtjes: CN-138691-05-08. Objekti ishte ("Punimet e ndert, treg. mater. ndertimit, import perdorim pajisje detare, analiza lende djegese") u be ("Ndertim, shfrytezim porti, shkarkim e analiza te lendeve djegese, ruajtje objekti, perdorim mjete detare") <u>Vlera e Kapitalit</u> ishte ("307.220.000,00") u be ("597.686.000,00") <u>Numri i Aksioneve</u> ishte ("307.220,00") u be ("597.686,00")

	<u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ:</u> Kane ndryshuar të dhënat për : (Pirro Bare) , Numri i Aksioneve ishte ("306.329,06") u be ("596.786,00") , Përqindja në kapital ishte ("99,71") u be ("99,84") , Kontributi në para ishte ("306.329.062,00") u be ("596.786,00") Kane ndryshuar të dhënat për : (Florencë Gjokuria) , Numri i Aksioneve ishte ("399,38") u be ("400,00") , Përqindja në kapital ishte ("13") u be ("06") , Kontributi në para ishte ("399.386,00") u be ("400.000,00") Kane ndryshuar të dhënat për : (Xhevat Rira) , Numri i Aksioneve ishte ("491,55") u be ("500,00") , Përqindja në kapital ishte ("16") u be ("08") , Kontributi në para ishte ("491.552,00") u be ("500.000,00") <u>Koment</u> ishte ("") u be ("U dorëzua bilanci i vitit ushtrimor 2007") Lista e Dokumenteve: <u>Bilanci vjetor</u> <u>Akti i emerimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihet në aktet e tjera</u> <u>Akti i ekspertimit të ekspertit vlerësues të licensuar për pagesën e kapitalit në natyrë</u>
9. 22/01/2009	Numri i çështjes: CN-208339-01-09 <u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratorët</u> Kane ndryshuar të dhënat për administratorin: (Veli Hoxha) , Nga Data ishte ("27/10/2003") u be ("31/12/2008") --, Në Datën ishte ("") u be ("31/12/2011") Lista e Dokumenteve: <u>Dokumenti origjinal i autorizimit nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar ose fotokopje e noterizuar</u>